

Titulli i lëndës: LETËRSI BASHKËKOHORE TURKE

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Letërsi bashkëkohore turke
Niveli:	BA
Statusi i lëndës:	I obligueshëm
Viti i studimeve:	Viti i III-të Semestri i VI-të
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	5 ECTS
Koha / Vendi:	Klasa 102 Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. ass.dr. Zeqije Xhafçe
Të dhënat kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës:	Lënda “Letërsi bashkëkohore turke” përfshin letërsinë turke të shekullit 19 dhe 20. Këtu përfshihen periudha të rëndësishme letrare e kulturore të cilat e dërguan shoqërinë turke drejt ndryshimeve sociale e kulturore. Fillohet me periudhën e Tanzimatit, që shenon fillimin e modernizimit të letërsisë turke dhe shënon romantizmin e letërsisë turke, duke përmendur figurat kryesore dhe format letrare që ata i sollën letërsisë turke, si: poezia e stilit të lirë, romani, tregimi, drama etj. Pastaj flitet për shkollat dhe rrymat e reja si ajo e Serveti Funun-it që paraqet simbolizmin në letërsinë turke, dhe rryma Genç Kalemler që kanë ndikuar në lindjen e letërsisë nacionale turke. Dhe në fund, krejt shkurtimisht, studentët do të njihen me faktorët shoqëror, politik dhe kulturor të cilët kanë paraqitur themelet për lindjen e letërsisë turke të periudhës republikane. Duke filluar me Nazim Hikmetin, nismëtar i vargut të lirë, pastaj do të dallohen poetët bashkëkohor turqë Fazëll Hysni Dagllarxha, Jahja Kemal, Nexhip Fazëll, Xh. Sitki Taraxhi etj. e deri tek romansierët e

	famshëm Jashar Kemali, Elif Shafak e Orhan Pamuku, nobelisti i vetëm i letërsisë turke.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimet kryesore konsistojnë në faktin që të aftësojnë student për të nxënë njohuri për rrjedhat e zhvillimin të letërsisë bashkëkohore, respektivisht për risitë letrare që periudha e Tanzimatit i solli letërsisë bashkëkohore turke, sikur janë zhanret: poezia e lirë, drama, romani, tregimi. Pastaj rrymat letrare romantizmi e simbolizmi te ndikuara drejtpërdrejt nga letërsia perendimore. Njëherit të ketë njohuri të mjaftueshme edhe për përfaqësuesit më eminent të letërsisë bashkëkohore turke që përfshihen në këtë cikël të cilët konsiderohen rilindasit e letërsisë turke, si: Ibrahim Shinasiu, Namik Kemali, Zija Pasha, Shemsettin Sami, Abdulhamid Tarahan, Rexhaizade Ekrem, Tevfik Fikret etj; si edhe për bartësit e letërsisë së re-nacionale turke, si: Jashar Kemal, Nazim Hikmet, Dagllarxa, Orhan Pamuk etj.
Rezultatet e pritshme të nxënies:	Pas përfundimit të këtij kursi studenti : <ul style="list-style-type: none"> - definon kontekstin kulturor-historik të zhvillimit të letërsisë moderne turke; - përshkruan rrjedhat e zhvillimit të letërsisë bashkëkohore turke, respektivisht risitë letrare që

	periudha e Tanzimatiti solli letërsisë bashkëkohore turke.
	- krahason shkollat letrare që shfaqen pas periudhës së tanzimatit dhe të përshkruajë risitë që ato i sollën letërsisë bashkëkohore turke.
	- diskuton për ndryshimin stilistik, tematik dhe përmbajtësor që letërsia bashkëkohore turke e pësoi pas lindjes së letërsisë nacionale.
	- prezanton rezultatet e letërsisë bashkëkohore turke të periudhës republikane dhe rolin e tyre në letërsinë bashkëkohore botërore.
	- dallon veçoritë karakteristike të letërsisë turke të kësaj periudhe;

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtime	2	15	30
Punë praktike	1	10	10
Përgatitje për test intermediary			5
Konsultime me mësimdhënësin	1	4	4
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit			5
Detyrë shtëpie	1	15	15
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja për provimin final			8
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			3
Projektet, prezantimet, etj.			
Total			125 orë 5 ECTS

Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratat, ushtrimet gjatë orëve të mësimit duke përdorur materiale të ndryshme, punë në grup prej 2-3 studentësh në një projekt (punë e pavarur), detyrë shtëpie individuale.
Metodat e vlerësimit:	Kufiri i kalueshmërisë së lëndës është 60%. Vijueshmëria e studentit 10%; Kollokviumi 30% Provimi final 60%.
Literatura primare:	1. Şemsettin Kutlu, Tanzimat Dönemi Türk Edebiyatı Antolojisi, Bateş yayınları, İstanbul, 1972.; 2. Şemsettin Kutlu, Servetifünün Dönemi Türk Edebiyatı Antolojisi, Bateş Yayınları, İstanbul, 1972. 3. Abdullah Hamiti, <i>Pasqyrë e letërsisë bashkëkohore turke</i> , (dispensë për përdorim intern).
Literatura shtesë:	1. Şemsettin Kutlu, Başlangıçtan Günümüze Kadar Türk Romanları, 5. Baskı, İstanbul, 1987; 2. Mahir Ünal – Ömer Özcan, 20. Yüzyıl Türk Edebiyatı, İstanbul, 1987; 4. Halman, Talat Sait dhe tjerë, <i>Türk Edebiyatı Tarihi</i> , vëllimi 3, Ankara, 2007; 5. Kudret, Cevdet, <i>Türk Edebiyatında Hikaye ve Roman I: Tanzimat'tan Meşrutiyet'e kadar (1859-1910)</i> , İstanbul, 1987; 6. Korkmaz, Ramazan, <i>Yeni Türk Edebiyatı: El Kitabı (1839-2000)</i> , Ankara, 2006; 7. Orhan Okay, <i>Letërsia turke gjatë periudhës së perëndimizimit</i> , në: Historia e Shtetit, Shoqërisë dhe Qytetërimit Osman II, përgatiti Ekmeluddin İhsanoğlu, (f. 102-1341), Tiranë: AİİTC, 2009; 8. Finn, Robert, Turk Romanı: İlk Dönem (1872-1900), İstanbul, 2003; 9. M. Fatih Andi, Edebiyat Araştırmaları, I, İstanbul, 2000, s. 309; 10. Turan Karataş, Ansiklopedik Edebiyat Terimleri Sözlüğü, İstanbul, 2001; Të gjitha veprat e letërsisë turke të përkthyer në gjuhën shqipe.

Hartimi i planit mësimor

Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	Rrethanat politike e kulturore në Turqi gjatë Tanzimatit -Karakteristikat e letërsisë turke të Tanzimatit.
Java 2:	Zhvillimi i dramaturgjisë turke në periudhën e Tanzimatit.

Java 3:	İbrahim Shinasıu, Zija Pasha, Namik Kemali dhe Shemsettin Sami -rilindësit e letësisë turke.
Java 4:	Ibrahim Shinası, Zija Pasha, Namik Kemal dhe Shemsettin Sami -rilindësit e letësisë turke.
Java 5:	<i>Roli i shkollës së Servet-i Fununit në modernizimin e letësisë turke</i>
Java 6:	<i>Abdulhak Hamid Tarhan, Rezaizade Mahmut Ekrem, Halid Ziya Uşaklıgöl dhe Tefvik Fikret – përfaqësuesit kryesor të shkollës së Serveti Fununit...</i>
Java 7:	<i>Abdulhak Hamid Tarhan, Rezaizade Mahmut Ekrem, Halid Ziya Uşaklıgöl dhe Tefvik Fikret – përfaqësuesit kryesor të shkollës së Serveti Fununit..</i>
Java 8:	Letërsia e Shekullit XX - Letërsia nacional-demokratike turke - Shkollat letrare Fecri Ati dhe Genç Kalemler të cilat i paraprinë letërsisë nacionale. Përfaqësuesit Zija Gökalp e Omer Sejfettin.
Java 9:	Neoklasikët Jahja Kemal, Mehmet Akif Ersoj dhe Ahmet Hashim të cilët i ringjallën format e lashta poetike.
Java 10:	Poezia filozofiko/fetare e Nexhip Fazëll Kësakyrek-ut. Nazim Hikmeti- flamurtar i letërsisë së re revolucionare.
Java 11:	Romansierët e parë turq të periudhës së Xhumhurijetit Mbi romanet e Halide Edip Adivar, Jakup Kadri Karaosmanogllu, Reshat Nuri GynTekin.
Java 12:	Romanet me tematikë sociale nga Anadolli të Orhan Kemal e Jashar Kemal.
Java 13:	Novelistët e parë bashkëkohorë turq Sait Faik Abasıyank, Sabahattin Ali e Orhan Kemal.
Java 14:	Poezia dhe poroza bashkëkohore turke dhe përfaqësuesit më të dalluar – Orhan Pamuk nobelisti i vetëm turk.
Java 15:	Vlerësimi dhe diskutimi lidhur me detyrat në klasë dhe në shtëpi gjatë semestrit dhe përgatitja për provimin final.

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Mjetet që përdoren gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore. Vijimi në ligjëratat dhe ushtrime duhet të jetë i rregullt, gjatë mbajtjes së mësimit duhet të mbretërojë qetësia, të shkyçen telefonat celular si dhe hyrja në sallë duhet të jetë me kohë. Plagjiazmi dhe kopjimi në provime janë të dënueshme; studenti merr note negative.

